

## NË EMËR TË POPULLIT

09.07.2018

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal**, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit **L. S.** nga Prizreni me mbrojtësin e tij av. **Q. K.** nga Prizreni, për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bigjazit të kunderligjshem nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 31 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr.3764/15 të datës 08.12.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit të shtetit në Prizren Mehreme Hoxha, të akuzuarit me datë **06.06.2018**, morri dhe shpalli publikisht këtë:

**A K T G J Y K I M****I akuzuari**

**L. S.** nga i ati **N. e** ëma **N.** e vajzërisë **J.** i lindur më datë në Prizren, ku edhe jeton në rr. **K.** nr. ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar baba i 2 femijeve, i gjendjes së dobët ekonomike, turk, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse me dt. 05.06.2015, rreth orës 20,00 min, në Prizren në rr. **B.** Sh. pikerisht në firmën e tyre në bashkeveprim me qëllim të përfitimit të kunderligjshëm të dobis pasurore për vehtë apo personin tjetër, organizojnë, marrin pjesë apo ndihmojnë në organizimin e bigjazit, lojerave të llojit të kazinove apo lojerave të fatit, të cilave nuk i është dhënë licenca, leja ose konsesioni i organit kompetent, në atë mënyrë që me rastin e kontrollit nga zyrtarët e ATK-es, policisë së Kosovës dhe Doganës, janë gjetur 3 aparate të lojerave të fatit gara me qen, dhe bastore të palicencuara,

-kësodore kryen veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bigjazit të kunderligjshëm nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 3 par.2, 7, 8, 9, 10, 23 par.2, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73, 74, 75 par.1 nenpar.1.3, të KP-se, dhe neni 365 të KPP-es të akuzuarit i shqipton:

**D E N I M M E B U R G**

Në kohezgjatje prej **4 /kater/ muajve**.

Duke aplikuar nenin 3 par.2 të KP-se, në bazë të nenit 47 të KP-se, me pelqimin e të akuzuarit **Lindi Skeja** dhe mbrojtësit të tij av. **Q. K.** denimi i shqiptuar me burgim në kohzgjatje prej 4 /kater/ muajve, zëvendsohet me denim me gjobe në shumën prej **700,00 eurove**, të cilin denim me gjobe i akuzuari **Lindi**, është i obliguar të paguajë në afatin prej 15 diteve, pas plotefuqishmerisë së këtij aktgjykimi, i akuzuari denimin me

gjobe do te paguaj ne 3 kiste. Nese i akuzuari nuk deshiron apo nuk do te mund te paguaje denimin me gjobe, i njejti denim do ti zevendsohet me denim burgu duke llogaritur per çdo 20 euro 1 dite burgim, rrespektivisht nga shuma e denimit me gjobe te paguaj denimin e shqiptuar me burgim prej 4 muajve.

Gjykata te akuzuarit krahas denimit kryesor i shqipton edhe denimin plotesues dhe ate marrjen – konfiskimin e nje shtepize kompjuteri HP me nr.serik CZC9211326, e nje shtepize kompjuteri HP me nr.serik CZC6450MOD, e nje shtepize kompjuteri HP me nr.serik CZC4371MB7, nje CD te dhena nga agjencioni per forenzik, tiketa loto sport, tiketa keno, tiketa gara me qen, printer epsun, monitor elo, monitor del, monitor hip, printer tyso, fletore e shenimeve me mbishkrimin polisan, 216 euro para te gatshme.

-ne kuptim te nenit 62 par.1 e 2 p.1.7 e neni 69 te KP-es,

I akuzuari obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates, dhe ato ne emer te shpenzimeve te paushalit gjyqesor shumen prej **30,00 Euro**, ne emer te kompenzimit per viktimat e krimit shumen prej **30 eurove**, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotefuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nen kerchim te ekzekutimit te dhunshem.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP. nr.3764/2015 te dt.08.12.2016, kunder te akuzuarit **L . S .** nga Prizreni, per shkak te vepres penale organizimi i skemave piramidale dhe bigjazit te kunderligjshem nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 31 te KP-es.

Gjykata ne shqyrtim fillestar ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajit per vepren penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale, organizimi i skemave piramidale dhe bigjazit te kunderligjshem nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 31 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtorë dhe i shqiptoi denimin me burgim si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tij penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat renduese dhe lehtesuese ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke gjetur si rrethana posaqerisht renduese, shkallen e pergjegjesise penale, intenzitetin e rrezikimit, vepra penale ka per qellim perfitimin e kunderligjshem te dobis pasurore per vehte, apo personit tjeter permes lojerave te llojit kazino dhe lojerave te fatit si lojera te ndaluara me ligj dhe ato gara me qen – keno, si dhe rrethanat nen te cilat eshte kryer vepra, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tij, si dhe ne kuptim te nenit 74, 75, 76 gjykata morri per baze edhe faktin se i akuzuari ka

bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tijë ka qenë vullnetar në hetimin dhe ndjekjen penale, si rrethane posaqerisht lehtësuese për të akuzuarin është marrë pranimi i fajësisë, gjendja e dobët ekonomike, i pa punë, mbajtës i familjes 4 anetareshe, andaj gjykata me aplikimin e nenit 47 dhe 75 par.1 nenpar.1.3 të KP-e të Kosovës, me pelqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tijë i ka shqiptuar dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë i kujdesshem dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi dënimin plotësues gjykata e bazoi në kuptim të nenit 62 e 69 të KP-es.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450, e 451 të KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr. 2700/2016 të datës 31.05.2018**

**Sekretare Juridike**  
**Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari**  
**Fatmir Krasniqi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kunder këtij aktgjykimi pala e pakenaqr ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet të kesaj gjykate.